

III KONSUMI DHE INVESTIMET

Konsumi dhe kursimi- Konsumi paraqet shpenzimet e konsumatoreve privat per mallra konsumi, pra per mallra qe perdoren per te nxjerre dobi ne periudhen korente. Pjesa e pashpenzuar per konsum korrent e te ardhurave te disponueshme paraqet kursimin pra

$$\underline{YD=C+S}$$

Yd-Te ardhurat e disponueshme, **C**=Konsumi dhe **S**(savings)- Kursimi

Konsumi paraqet perfaqesimin me te madh ne GDP te nje vendi. Ne vendet e industrializuara pesha e tij ne GDP arrin deri 65%. Konsumi dhe kursimi varen nga te ardhurat e disponueshme pra jane funksioni i te ardhurave. Pra faktori i pare percaktues i konsumit(C) dhe kursimit(S) jane te ardhurat e disponueshme(YD)

Shtesa e konsumit per qdo njesi monetare te te ardhurave te disponueshme quhet **prirja marxhinale per konsum(MPC)**..

Shtesa e kursimit per qdo njesi monetare shtese te te ardhurave te disponueshme quhet **prirja marxhinale per kursim(MPS)**

Yd=C+S athere **MYD=MC+MS** dhe **MPC+MPS=1** (**MYD=1** njesi monetare) ku **MC=konsumi marxhinal** dhe **MS=kursimi marxhinal** dhe **MYD=te ardhurat e disponueshme marxhinale...**

Mirpo per ta studiuar me mire sjelljen e konsumit dhe kursimit athere perdoren edhe keta tregeus (**APC**)-prirja mesatare per konsum dhe (**APS**)-prirja mesatare per kursim... **APC=C/YD** dhe **APS=S/YD...**

Algjebriht funksioni liner i konsumit shprehet me kete menyre:

$$\underline{C=a+bYD}$$

Faktoret tjere percaktues te konsumit- pra perveq te ardhurave te disponueshme(YD) qe eshte faktor kyq ne konsum, ai prap nuk eshte faktor i vetem qe ndikon ne konsum(C).

Nje faktore tjeter eshte edhe pasuria qe ndikon ne konsum, dhe ndikimi i saj eshte i rendesishem vetem kur ndryshon shpejte edhe ne permasa te medha. Gjithashtu edhe prej faktoreve tjere varet konsumi, si pritjet per te ardhurat, qmimet, taksat etj.

Nje nder teorite per te ardhurat qe ndikojne ne konsum eshte edhe "teoria e te ardhurave permanente" e ekonomistit amerikan FRIEDMAN, ai bazohet ne 3 koncepte themelore per kete teori: **konsumi permanent, te ardhurat permanente dhe te ardhurat tranzitore**. Sipas hipotezes apo *teorise se te ardhurave permanente*, konsumi permanent(C_p) eshte proporcional me te ardhurat permanente(Y_p), pra $C_p=kY_p$, ku $k=MPC=APC$.. sipas FRIEDMANIT te ardhurat aktuale mund te jene me te medha ose me te vogla se te ardhurat permanente. Diferencen midis tyre ai e quan e *ardhur tranzitore*. Te ardhurat tranzitore perfaqesojne rritjen ose renien e papritur te te ardhurave pra : **$Y=Y_p+Y_t$** ndersa konsumi permanent dhe te ardhurat permanente perfaqesojne prirjet afatgjate te konsumit dhe te ardhurave.... funksioni i konsumit sipas hipotezes se te ardhurave permanente eshte:

$C=kY_p$ ku C-konsumi aktual Y_p -te ardhurat permanente.

Investimet dhe faktoret percaktues te tyre- Me investim shpesh nenkuptohet qdo shpenzim per blerjen te nje ngastre toke, te letrave eksituese me vlere ETJ, mirpo ne keto raste kemi te bejme me transakcione financiare, mirpo me kuptimin rigoroz ekonomik, investim kemi vetem athere kur krijohet kapital i ri real, pra kur shtohet stoku i mallrave te prekshme kapital: makineri dhe pajisje, ndertesa dhe shtese inventari. Ne strukturen e investimeve pjesen kryesore e perbejne makinerite dhe pajisjet ndersa pejesen me te vogel e ze shtesa e inventarit.

Investimet dhe norma e interesit- nje nga faktoret kryesore qe ndikon ne investime ndoshta edhe me kryesori eshte *norma e interesit*. Sipas logjikes nje investim eshte i sukseshem vetem nese dobite e perfituar nga ai investim i kalojne kostot ose jane te barabarta me to. Kostoja e investimeve eshte me e komplikuar se e kostove te mallrave.

Norma reale e interesit=norma nominale e interesit-norma infalcionit.

Teoria e akseleratorit- sipas teorise se akseleratorit, niveli i investimeve **NETO** korrente varet nga ndryshimet ne te ardhurat. Kjo vartesi mund te shprehet me kete formule:

$$I_t = v(Y_t - Y_{t-1})$$

I_t -investimet neto
 Y_t -te ardhurat kombetare pe periudhen korrente
 Y_{t-1} --te ardhurat kombetare ne periudhen e meparshme
 v -konstantja e "akseleratorit"

mirpo mund ti nxerrim prej kesaj formule edhe investimet **BRUTO**:

$$GI = v(Y_t - Y_{t-1}) + R_t$$

GI -investimet bruto korrente
 R_t -amortizimi

Si dhe **akseleratori** na ndihmon te dime se pse prodhimi i te mirave kapital ndryshon shume me shpejte se sa prodhimi i te mirave ne pergjithsi.

Qe investimet neto te rriten, kerkesa duhet te rritet me nje ritem ne rritje, nese kerkesa mbetet konstante, investimet neto do te bien ne zero. Pra investimet agreegte varen nga kerkesa agregate, e cila ne ekuiliber eshte e barabart me te ardhurat kombetare (produkti kombetare). Pra do te kishim:

$$I_t = v(Y_t - Y_{t-1})$$

I_t -investimet neto
 Y_t -te ardhurat kombetare pe periudhen korrente
 Y_{t-1} --te ardhurat kombetare ne periudhen e meparshme
 v -konstantja e "akseleratorit"

-Si teoria qe i lidh investimet me normen e interesit ashtu edhe teoria e akseleratorit, kane kufizimet e tyre. Si dhe dishka tjeter: qeveria mund te ndikoj ne investimet private **se pari**: nepermjet politikave monetare, duke manipuluar me normen e interesit, **se dyti**: nepermjet

politikes fiskale dhe **se treti** nepermjet tonit te pergjithshem te politikave makroekonomike qe influencojne “klimen” e pergjithshme te nje vendi.

ARBER HOTI